



Prishtinë, 14.02.2017

### **Takim zyrtar me Ambasadoren e Turqisë në Kosovë znj. Kivilicim Kiliç**

Më ftesë të ambasadores së Turqisë në Kosovë znj. Kivilicim Kiliç, një delegacion i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, zhvilloj takim zyrtar në Ambasadën turke në Prishtinë. Nga KKTK ishin: Shafi Gashi, kryetar, Bego Kululleri, anëtar dhe Isuf Koci, u.d. udhëheqës ekzekutiv.

Në kuadër të këtij takimi u bisedua për mundësit e bashkëpunimit për të gjitha çështjet që lidhen me trashëgiminë kulturore në Kosovë dhe hapat e përbashkët që mund të bëjmë në të ardhmen.

Kryetari i KKTK-së, falënderoj ambasadoren për përkrahjen e vazhdueshme që kanë dhënë për Kosovën në të gjitha fushat, në veçanti në restaurimin dhe konservimin e trashëgimisë kulturore. Gjithashtu u njoftua edhe më sfidat që ka kaluar institucioni dhe të arriturat konkrete që janë bërë. Ambasadorja u njoftua më procesin e vlerësimit dhe shpalljes së njëzetetë (23) aseteve në mbrojtje të përhershme.

Ambasadorja znj. Kivilicim Kiliç, shprehu përkushtimin e saj për të ndihmuar Kosovën në fushën e trashëgimisë kulturore, përmes projekteve të shumta konkrete. Gjithashtu ne do të ofrojmë përkrahje edhe për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore si institucion mjaft i rëndësishëm për trashëgiminë kulturore.

Gjithashtu ambasadorja njoftojë kryetarin e KKTK për projektet e shumta që ka Turqia përmes organizatës TIKA. Të gjitha këto projekte janë dorëzuar në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, por ende nuk kemi marr përgjigje, prandaj kërkojmë që institucionet të jenë më bashkëpunuese, pasi që fondet e ndara mund të kthehen pas në Turqi si pasojë e vonësive në përgjigje.

U bisedua edhe për disa incidente që kanë ndodhur në disa objekte të kultit, që janë pjesë e trashëgimisë kulturore, dhe mundësit e ruajtjes dhe mbrojtjes më të mirë të këtyre objekteve.

Ambasadorja znj. Kivilicim Kiliç dhe kryetari Z. Shafi Gashi, shprehen vullnetin dhe gatishmërinë e bashkëpunimit në të ardhmen, duke parë këtë takim si fillim të mbarë për të dy institucionet.